

**VENDIM**  
**Nr. 620, datë 1.11.2017**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 34, DATË 7.1.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE DHE TRAJTIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992, "Për ndërmarrjet shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 34, datë 7.1.1999, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas shkronjës "g", të pikës 2, shtohen shkronjat "i" dhe "j", me përmbajtje:

"i) Ofrimin e shërbimeve të përgjithshme, në Kryeministri. Shpenzimet për këtë shërbim përballohen nga buxheti i shtetit.

Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare mund t'i kërkohet, pjesërisht apo tërësisht, ofrimi /transferimi i këtyre shërbimeve të përgjithshme edhe nga institucionet më të larta të shtetit, si Presidenca apo Kuvendi i Shqipërisë. Shpenzimet për shërbimet e ofruara përballohen nga buxheti i shtetit.

j) Organizimin e eventeve, si dhe të aktiviteteve ceremoniale, publike dhe jopublike, sipas kërkesës, duke trajtuar me përparësi nevojat e Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit dhe Kryeministrit. Shpenzimet për këto evente përballohen nga buxheti i vetë institucioneve."

b) Pika 16 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"16. Shpenzimet që kryhen nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe nënkryetarët e Kuvendit për evente dhe aktivitete ceremoniale, pritje, dreka e darka zyrtare, që jepen nga këto personalitete, si dhe shpenzimet për kafe, që bëhen nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri, përballohen nga fondet e vetë institucioneve që përfaqësojnë autoritetet e lartpërmendura."

2. Pozicionet dhe punonjësit aktualë në këto pozicione, në sektorin e shërbimeve të përgjithshme, në Departamentin e Administrimit dhe Shërbimeve, pranë Kryeministrit, kalojnë te struktura e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare. Kategoria e pagave për secilin pozicion të transferuar do të jetë e njëjtë me pozicione të ngjashme në strukturën e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.

3. Mjetet, materialet, makineritë, pajisjet, veglat në inventarin e Kryeministrit dhe që i shërbejnë funksioneve të transferuara kalojnë në inventarin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.

4. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**